REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE

Nr. 78 prot. Tiranë, më 08 maj 2019

# Vendim

**Nr. 6, datë 08 maj 2019**

## *Për shpalljen e të nominuarve të Çmimeve Shkencore Kombëtare 2018, që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë*

Juria e çmimeve shkencore kombëtare që organizohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, e krijuar me Urdhrin Nr. 11, datë 18. 04. 2019 *"Për ngritjen dhe përbërjen e Jurisë së çmimeve shkencore kombëtare vjetore për vitin 2018"*, e mbledhur sot më datë 8 maj 2019 në Akademinë e Shkencave, në përmbushje të përgjegjësive të veta dhe referuar:

- Ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, *"Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë"* neni 4, pika dh;
- Urdhrit Nr. 11, datë 6 tetor 2016 *"Rregullore për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; për mënyrën e organizimit të Konkurseve, për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre "*, neni 13;
- Vendimit të Kryesisë së ASH-së nr. 8, datë 28.06.2018 *"Për shpalljen e konkursit të çmimeve shkencore kombëtare që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë"*, edicioni i tretë (2018) shih: http://akad.gov.al/ash/pdf/Vendim_nr_8.pdf;
- Vendimit të Kryesisë së ASH-së nr.5, datë 24 prill 2019 *"Për shpalljen e listës së pjesëmarrësve në konkursin për çmimet shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitin 2018"*.

Pasi secili prej anëtarëve të saj u njoh me veprat e paraqitura në konkursin e çmimeve shkencore kombëtare për vitin 2018, pas diskutimeve të anëtarëve dhe votimit të fshehtë, në mbledhjen e saj të datës 8 maj 2019,

## Vendosi:

1. Të shpallë të nominuar për *Çmimin shkencor kombëtar vjetor "Eqrem Çabej"*, që jepet për studimin më të mirë *në fushën e shkencave shoqërore-albanologjike*, këto vepra:

| Nr. | Titulli i veprës | Autori |
|---|---|---|
| 1 | Sistemi tatimor në Shqipëri (Shek.XV-vitet 12 shek.XXI) | Adriatik Mateli |
| 2 | Arkitektura në Iliri (Parë si refleks i strukturës sociale dhe botës shpirtërore) | Apollon Baçe |
| 3 | Historia e shqiptarëve gjatë shek.XX | Grup autorësh |

**2.** Të shpallë të nominuar për *Çmimin shkencor kombëtar vjetor "Petrit Radovicka"*, që jepet për studimin më të mirë *në fushën e shkencave natyrore-teknike,* këto vepra:

| Nr. | Titulli i veprës | Autori |
|---|---|---|
| 1 | Paraja, banka dhe shoqëria | Aristotel Pano, Anastas Angjeli |
| 2 | Atlasi i Florës së Shqipërisë | Jani Vangjeli |

**3.** Të shpallë të nominuar për *Çmimin shkencor kombëtar vjetor për "Kërkuesin e ri më të suksesshëm" në fushën e shkencave shoqërore-albanologjike,* këto vepra:

| Nr. | Titulli i veprës | Autori |
|---|---|---|
| 1 | Le nekropoli meridionale di Phoinike. Le tombe ellenistike e romane | Giusepe Lepore, Belisa Muka |
| 2 | Etnografi në diktaturë: Dija, shteti dhe holokausti ynë | Olsi Lelaj, Nebi Bardhoshi |

5. Shpallja e nominimeve do të njoftohet publikisht në media.

6. Ngarkohet sekretaria e Jurisë që në bashkëpunim me Seksionet të hartojnë kalendarin e datave për paraqitjet publike të nominuarve, kalendar i cili duhet të shtrihet në periudhën 10-20 maj 2019.

7. Ngarkohet sekretaria e Jurisë, specialisti i IT-së, specialisti i komunikimeve shkencore, për publikimin e këtij vendimi, pas shpalljes publike të tyre.

8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**JURIA E ÇMIMEVE SHKENCORE KOMBETARE 2018:**

**Kryetar:** Akademik, Ethem Likaj, përfaqësues i Kryesisë së ASH-së.

**Anëtar:** Akademik i asociuar Gjoalin Shkurtaj, përfaqësues i Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike.

**Anëtar:** Akademik Edmond Pinguli, përfaqësues i Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike.

**Anëtar:** Akademike Aurela Anastasi, përfaqësuese e SSHSHA të Asamblesë së ASH.

**Anëtar:** Akademik Floran Vila, përfaqësues i SSHNT të Asamblesë së ASH.

**Anëtar:** Akademik Dhimitër Haxhimihali, përfaqësues i akademikëve mbi 75-vjeç

**Anëtar:** Robert Dumi, përfaqësues i Agjensisë së Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit pranë Ministrisë së Arsimit.

**Anëtar:** Redi Shtino, përfaqësues i Ministrisë së Arsimit.

**Anëtar:** Prof. Dr. Adrian Civici, përfaqësues prej rrjetit të universiteteve private shqiptare *"UET"*, gjegjësisht nga shkencat shoqërore.

**Anëtar:** Prof. Dr. Andrea Maliqari, përfaqësues prej rrjetit të universiteteve shqiptare me titull *"Profesor"*, gjegjësisht nga shkencat teknike-natyrore

**Anëtar:** Sokol Gjoka, përfaqësues i Komisionit Kombëtar të UNESCO-s pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

**Anëtar:** Prof. Enver Hysa, përfaqësues i Komisionit Kombëtar të AIESEE.

**Anëtar:** Andi Rrëmbeci, përfaqësues i Akademisë së të Rinjve pranë ASH.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AKADEMIA E SHKENCAVE -